

**Shkruar nga: Lirie Osmani**

## **ESE**

### **Tema: Si mund të shfrytëzohen fondet e BE-së në të mirë të komunitetit ku jetoni?**

Bashkimi Evropian në vazhdimësi hap programe për financimin e projekteve të ndryshme komunitare, varësisht prej fushave të parapara për të investuar. E vërteta qëndron që BE-ja kërkon projekte serioze. Ajo realizon një mbikëqyrje të rreptë dhe transparente të shpenzimit të atyre fondeve, por mbi të gjitha fokus i veçantë vihet mbi qëndrueshmërinë e projektit, tek efektshmëria dhe jetëgjatësia.

Duke pasur parasysh faktin që 27 komisioner të BE-së kanë përgjegjësinë përfundimtare politike për të siguruar që fondet e BE-së të shpenzohen si duhet dhe duke pasur parasysh faktin që BE-ja analizon pikë për pikë secilin projekt (se sa i përmbahet thirrjes), me shumë seriozitet, ne obligohemi të ofrojmë projekttefektiv, si garanci relative që si i tillë mund të kalojë në fazat e tjera.

Pasi që këto ditë gjendemi në fazën e programeve të hapura të BE-së, respektivisht Programit për bashkëpunim ndërkuftar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut, në mënyrë hipotetike do të paraqesim një ide, përmes së cilës fondet e BE-së do të shfrytëzoheshin në të mirë të komunitetit tim, duke iu përmbajtur thirrjes në fushat e parapara të aplikimit, atë të ambientit dhe turizmit. Në qytetin e Ferizajt, në vendin ku jetoj, kemi mundësi të inkurajimit të restaurimit dhe ri- përdorimit të ndërtesave të trashëgimisë kulturore, si dhe mbështetjen e ndarjes së praktikave dhe promovimin e përsosmërisë në këtë fushë.

Një objekt i fillim-shekullit XX, respektivisht ndërtesa e vjetër e njëres nga shkollat e Ferizajt është një nga të paktat ndërtesa që i ka mbijetuar kohës. E vendosur në qendër të qytetit, kjo ndërtesë është e lidhur ngushtë me kulturën urbane të qytetit. Brezat e nxënësve kanë qenë pjesë e kësaj shkolle dhe kujtimet me këtë objekt janë pjesë integrale e brezave që tashmë janë plakur në këtë qytet. Edhe sot, ata e përdorin këtë objekt si pikë referimi kur takohen me miqtë.

Në njëzet vitet e fundit, qyteti i Ferizaj shënoi një rritje të shpejtë, si në aspektin e popullsisë ashtu edhe në aspektin e zhvillimit të biznesit dhe ekonomisë. Gjithashtu, numri i nxënësve u rrit, duke e bërë objektin ekzistues të pamjaftueshëm për zhvillimin e veprimtarive arsimore. Kjo ndërtesë shkollore ishte funksionale deri në vitin 2003 kur u ndërtua ndërtesa e re shkollore. Që atëherë ajo është lënë në mëshirën e kohës duke pësuar degradim të vazhdueshëm. Për më tepër, objekti është shndërruar në një mjedis informal mbeturinash që mban erë të keqe, bile edhe mundësi përdorimi të narkotikëve, duke rrezikuar shëndetin e banorëve përreth.

Sidoqoftë, qytetarët e Ferizaj janë kundër shembjes së kësaj ndërtese. Përmes këtij objekti ata ruajnë me fanatizëm kujtesën e qytetit tonë. Dominimi i ndërtimeve të paligjshme dhe të parregullta

përfaqëson në të njëjtën kohë rënien e traditës urbane dhe rrezikon bashkëveprimin kulturor. Vendet kulturore urbane janë gjeneratorë të kulturës masive, si një mjet për fuqizimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Mbrojtja kulturore mund të ndihmojë për të fituar një cilësi më të lartë të jetesës në një kontekst më të aftë ekonomik dhe shoqëror.

Pra ideja ime do të ishte ndërhyrja në infrastrukturë në Ferizaj, respektivisht ndërtesa më e vjetër e shkollës të ishte restauruar, konservuar dhe përshtatur si Inkubator i Trashëgimisë Kulturore me ambientembështetëse në komunën e Ferizajt.

Ky objekt posedon gjithësej pesë (5) klasë apo hapsira të ndara. Në një projekt hipotetik, pas një ristaurimi të planifikuar, ato do të kishin:

### **Inkubatorin e trashëgimisë kulturore.**

**Qendrën profesionale** - Një hapësirë në të cilën komuna do të organizojë aktivitete të përbashkëta me grupe të caktuara të interesit (gra, të rinj, persona me aftësi të kufizuara, organizata të shoqërisë civile) duke ofruar mundësi që ata të përdorin këtë hapësirë për të kryer aktivitetet e tyre.

**Qendra Informative Kulturore dhe Turistike** - Një hapësirë ku informacioni do të mbështesë mundësitë turistike dhe kulturore të ofruara nga komuna e Ferizajt. Misioni i tij është të funksionojë si pika qendrore për kulturën dhe informacionin në nivelin lokal në Ferizaj. Zhvillimi i paketave turistike për vendet e drejtimit turistik dhe pasuritë e tyre të trashëgimisë kulturore në Ferizaj do të ishte ndër aktivitetet e Qendrës.

**Galeria e Forumit** - kushtuar fotografisë bashkëkohore dhe arteve pamore kryesisht për promovimin e vendeve kulturore dhe turistike në Ferizaj.

**Salla e muzeut** - do të mbledhte objekte të ndryshme kulturore nga qyteti dhe rrethina e Ferizajt që pasqyrojnë vlerat kulturore të komunës.

*Pra, me ristaurimin e këtij objekti, do të siguronim një mundësi më shumë për komunitetin, dhe një rrezik më pak për të rinjtë!*